

RESU

Transhumance
Resilience and
Utilisation for
Sustainable
Transformation

reinforcesustainability.com

Transhumanca në Shqipëri: Vlerësimi i situatës aktuale dhe Perspektivat e Përshtatjes Klimatike

Prill 2025



EUROPA
NOSTRA



Alliance internationale
pour la protection
du patrimoine dans
les zones en conflit



European
Heritage
Hub



Co-funded by
the European Union

Thanks to the support of the European Heritage Hub pilot Project co-funded by the European Union and supported by the ALIPH Foundation

AUTORËT

Prof. Zef GJETA

Prof.Asc. Ilirjan BAKIASI

Oljam DERVISHI

Tiranë, Prill 2025

© 2025 nga RESU-Reinforce Sustainability. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

RESU-Reinforce Sustainability

Adresa: Rr. Naim Fashëri, Tiranë

Email: info@reinforcesustainability.com

Website: reinforcesustainability.com

SHËNIM

Ky raport është përgatitur nga Reinforce Sustainability (RESU) në kuadër të projektit “TRUST: Transhumance Resilience and Utilisation for Sustainable Transformation”. Pikëpamjet dhe përfundimet e paraqitura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet apo opinionet e Europa Nostra, Bashkimit Evropian, Fondacionit ALIPH apo Konsorciumit të European Heritage Hub.

Autorësia e këtij botimi i përket ekskluzivisht RESU-së. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, ruhet apo transmetohet në çfarëdo forme apo mënyre, elektronike apo tjetër, pa miratimin paraprak me shkrim nga RESU.

PËRMBATJA

1. Parathenie.....	5
2. Permbledhje Ekzekutive.....	5
3. Sfondi i studimit	6
3. Konteksti i Transhumancës në Shqipëri	7
3.1 Korniza Ligjore dhe Strategjike për Transhumancën në Shqipëri	8
4. Metodologjia	9
4.1 Grumbullimi i përgjithshëm informacionit	9
4.2 Grumbullimi i të Dhënave nga Veterinerët.....	10
4.3 Grumbullimi i të Dhënave nga Barinjtë në Terren	10
4.4 Përpunimi i të dhënave	10
5. Hartëzimi i Aktorëve në Ruajtjen dhe Zhvillimin e Transhumancës në Shqipëri	10
5.1 Komuniteti lokal dhe praktikuesit.....	11
Barinjtë (Praktikuesit tradicionalë)	11
5.2 Institucione publike.....	11
5.2.1 Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR)	11
5.2.2 Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI).....	11
5.2.3 Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF)	12
5.2.4 Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM).....	12
5.2.5 Njësitë e Qeverisjes Vendore.....	12
5.2.6 Organizata të Shoqërisë Civile dhe Aktorë të Terrenit	12
5.2.7 Akademia dhe kërkimi shkencor	13
6. Gjetjet kryesore dhe diskutimet	15
6.1 Rezultatet nga të dhënat institucionale dhe studimi bibliografik.....	15
6.1.1 Përmasa e Transhumancës në Shqipëri	15
6.2.2 Politikat dhe projektet mbështetëse për transhumancën.....	16
6.2 Gjetjet nga intervistat me barinjtë.....	18
6.2.1 Përbërja e tufës dhe karakteristikat e lëvizje.....	18
6.3 Gjetjet nga të dhënat e veterinerëve.....	19
6.3.1 Profili demografik.....	19
6.3.2 Analiza tematike e përvojës dhe vlerësimeve të veterinerëve.....	20
6.3.3 Vlerësimi i praktikës së transhumancës nga veterinerët	23



6.3.4 Dinamika e Sëmundjeve në Kontekstin e Ndryshimeve Klimatike	25
6.3.4 Përshtatja e Praktikës së Transhumancës përballë Ndryshimeve Klimatike: Sfidat dhe Masat nga veterinerët.....	27
7. Konkluzione.....	29
8. Referencat.....	31



1. Parathenie

Ky raport vjen si produkt i një përpjekjeje të koordinuar dhe me vlerë kërkimore të ndërmarrë nga RESU – Reinforce Sustainability, në kuadër të projektit TRUST – Transhumance Resilience and Utilisation for Sustainable Transformation, të mbështetur nga Europa Nostra dhe partnerë të tjerë evropianë. Vendimi për të realizuar këtë studim buron drejtpërdrejt nga misioni i organizatës sonë për të fuqizuar të rinjtë si agjentë të zhvillimit të qëndrueshëm dhe për t'i afruar ata me natyrën, trashëgiminë dhe jetën rurale.

Transhumanca përfaqëson më shumë se një traditë blegtorale – ajo është një sistem i të jetuarit që bart me vete dimensione historike, ekologjike dhe kulturore. Ajo lidhet ngushtë me përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, me respektin për ciklet sezonale dhe me ndërtimin e identitetit rural shqiptar. Pikërisht për këtë arsye, RESU e ka parë si detyrë të angazhohet në dokumentimin, analizimin dhe promovimin e kësaj praktike në përballje me sfidat e kohës, sidomos ato që vijnë nga ndryshimet klimatike dhe braktisja rurale.

Edhe pse ky projekt nuk parashikonte detyrimisht përfshirjen e të rinjve në fazat kërkimore shkencore, të rinjtë e përfshirë në RESU kanë luajtur një rol kyç në implementim. Ata kanë marrë pjesë në fazën e grumbullimit të të dhënave në terren, kanë ndihmuar në krijimin e materialeve vizuale dhe promovuese, si dhe në ndërgjegjësimin publik mbi rëndësinë e fenomenit përmes rrjeteve sociale të organizatës. Angazhimi i tyre ka qenë frymëzues dhe ka dëshmuar që rinia shqiptare, kur i jepet hapësirë dhe drejtim, është e gatshme të kontribuojë në çështje me rëndësi kombëtare dhe globale.

Reagimi i publikut ndaj këtij studimi ka qenë mjaft pozitiv, me interes të shtuar për të kuptuar më shumë rreth praktikës së transhumancës dhe lidhjes së saj me zhvillimin e qëndrueshëm. Për këtë arsye, shprehim një mirënjohje të veçantë për mbështetjen e Europa Nostra dhe partnerëve që mundësuan këtë proces të rëndësishëm dokumentimi dhe reflektimi.

Ky raport vjen si një kontribut i sigurt dhe i bazuar në evidencë, për të mbështetur institucionet publike, akademinë dhe aktorët lokalë në ruajtjen, rimendimin dhe përshtatjen e transhumancës në kushtet e reja të shoqërisë shqiptare.

Ekipi i RESU (Reinforce Sustainability)

2. Permbledhje Ekzekutive

Ky raport përfaqëson një analizë të parë të thelluar mbi ndikimin e ndryshimeve klimatike në transhumancën shqiptare, duke kombinuar të dhëna nga institucione publike, anketime me veterinerë dhe intervista në terren me barinj në pesë rajone të Shqipërisë. Ai ofron një pasqyrë të qartë mbi sfidat aktuale dhe karakteristikat që po përcaktojnë ritmin e ndryshimit të kësaj praktike tradicionale.

Në Shqipëri, referuar të dhënave zyrtare nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, numri i barinjve të regjistruar është 2,826, por shumica e tyre operojnë në mënyrë të pavarur dhe joformale. Rreth 7% e tyre pra 400 ferma në Shqipëri ushtrojnë ende praktikën e transhumancës. Ndërkohë, nga 87 veterinerët e anketuar, mbi 70% konfirmojnë se kanë vërejtur një rënie të ndjeshme të numrit të

barinjve dhe bagëtime që praktikojnë transhumancën, duke e lidhur këtë fenomen me faktorë si emigrimi, mungesa e të rinjve në bujqësi, dhe kushtet e pafavorshme klimatike.

Në të njëjtën linjë, barinjtë e intervistuar raportojnë se praktika e shtegtimt ka ndryshuar ndjeshëm, me vonesa sezonale në nisjen për në mal dhe kthime më të hershme në ultësira, si pasojë e temperaturave të larta dhe mungesës së burimeve ujore. Shumica e barinjve janë të përqendruar në transhumancën vertikale, duke lëvizur tufat në lartësi malore gjatë verës, por theksojnë se mungesa e statusit të qartë ligjor dhe qasjes në kullota publike mbeten ndër sfidat më të mëdha për ruajtjen e praktikës. Nga ana e veterinerëve, është vënë re një rritje e ndjeshme e sëmundjeve infektive të lidhura me ngarkesën termike dhe streset mjedisore, sidomos në periudhat e transicionit sezonal. Përgjigjet e tyre tregojnë se rritja e vaksinimeve dhe ndryshimi i racave të bagëtime janë ndër masat më të zakonshme të adaptimit, por shpesh të pamjaftueshme pa mbështetje më të strukturuar nga autoritetet publike.

Po ashtu, shumë aktorë lokalë dhe ekspertë theksojnë se mungesa e të dhënave zyrtare dhe monitorimit të përhershëm të fenomenit është një pengesë për formulimin e politikave afatgjata. Kjo ngre një pyetje thelbësore për të ardhmen: Si mund të përfshihet transhumanca në strategjitë kombëtare të përshtatjes ndaj klimës dhe zhvillimit rural, pa humbur karakterin e saj tradicional?

Ky raport nuk pretendon të japë përgjigje përfundimtare për të gjitha çështjet që lidhen me transhumancën, por ai përbën një hap të parë të rëndësishëm në dokumentimin dhe analizimin e praktikës në kushtet aktuale, duke synuar të nxisë një qasje më të thelluar dhe të bashkërenduar për mbrojtjen dhe përshtatjen e saj në të ardhmen.

3. Sfondi i studimit

Transhumanca është një praktikë tradicionale që përfshin lëvizjen sezonale të bagëtime midis kullotave të ndryshme, në përputhje me ritmet klimatike dhe ekologjike të territorit. Në shumë rajone të Europës dhe të botës, kjo mënyrë jetese ka përbërë një sistem kompleks të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, duke lidhur dimensionin ekonomik të mbijetesës së komuniteteve rurale me trashëgiminë kulturore dhe ruajtjen e biodiversitetit (Rodríguez-Estévez, 2010; Casas & Manzano, 2010). Në Shqipëri, transhumanca ka qenë për shekuj një praktikë thelbësore në zonat malore dhe të thella të veriut dhe jugut, ku kushtet klimatike dhe gjeografike e kanë diktuar lëvizjen sezonale si një nevojë biologjike dhe kulturore.

Në dhjetor të vitit 2023, transhumanca shqiptare u njoh zyrtarisht nga UNESCO si pjesë e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të Njerëzimit, duke e vendosur praktikën në një status ndërkombëtar që kërkon veprime të drejtpërdrejta për ruajtjen dhe përshtatjen e saj. Kjo arritje përforcon nevojën për politika kombëtare që njohin vlerën e saj kulturore, mjedisore dhe socio-ekonomike, sidomos në një periudhë ku presionet e brendshme dhe të jashtme e kërcënojnë vazhdimësinë e saj.

Pavarësisht rëndësisë së njohjes, transhumanca shqiptare përballet sot me një sërë sfidash që rrezikojnë jo vetëm praktikën si të tillë, por edhe ekosistemin social dhe ekologjik që ajo ndërton rreth vetes. Raportet dhe studimet e kryera më parë në veri të vendit evidentojnë se praktikuesit e transhumancës po përballen me plakje të popullsisë, shpopullim të vazhdueshëm të zonave rurale, mungesë investimesh në infrastrukturë, fragmentim të kullotave dhe mbështetje të pamjaftueshme

institucionale (Gjeta, 2021). Në të njëjtën kohë, ndryshimet klimatike po ndryshojnë kushtet natyrore të kullotave, disponueshmërinë e ujit dhe ritmet sezonale të shtegimit, duke krijuar vështirësi të reja për një praktikë që ka qenë përherë fleksibël ndaj natyrës, por që tani përballlet me ritme dhe intensitete transformimi jashtëzakonisht të larta (Adaptation Milou Albania, 2022; Risk Perception of Transhumance, 2022). Ndërkohë që ka pasur përpjekje për të dokumentuar trashëgiminë kulturore të transhumancës, përfshirë edhe një iniciativë të mëparshme të organizatës Reinforce Sustainability (RESU) me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës në vitin 2022, deri më tani mungon një qasje analitike dhe gjithëpërfshirëse mbi mënyrën sesi ndryshimet klimatike po ndikojnë realisht në praktikën e transhumancës në Shqipëri. Në këtë pikë, lind nevoja për të mbledhur prova, perceptime dhe të dhëna që shkojnë përtej folklorit dhe përshkrimit kulturor, dhe që ndihmojnë në kuptimin e kapaciteteve ekzistuese për përshtatje, dobësive sistematike dhe mundësive për ndërhyrje.

Pikërisht në këtë drejtim ndërtohet projekti TRUST – Transhumance Resilience and Utilisation for Sustainable Transformation, i zbatuar nga RESU me mbështetjen e Europa Nostra. Ky projekt shërben si një vazhdim dhe thellim i punës së mëparshme të organizatës në dokumentimin e transhumancës, duke kaluar nga vëzhgimi kulturor në një analizë shumëdimensionale mbi qëndrueshmërinë e saj në kushtet e krizës klimatike. Studimi synon të mbledhë të dhëna nga barinjët dhe veterinerët në terren, të analizojë perceptimet lokale dhe institucionale, dhe të propozojë një set rekomandimesh për përshtatje strategjike, ndër-institucionale dhe komunitare.

Për më tepër, projekti shikon transhumancën jo vetëm si një praktikë ekonomike tradicionale, por si një strategji funksionale për përshtatje klimatike, për ruajtjen e territorit dhe biodiversitetit, si dhe për forcimin e lidhjes së komuniteteve me identitetin e tyre kulturor. Duke integruar këtë praktikë në politikat e zhvillimit rural dhe të integritetit europian, TRUST synon të kontribuojë edhe në kuadrin e kapitujve 11 dhe 12 të *acquis communautaire* të Bashkimit Europian, duke i dhënë transhumancës shqiptare një pozicion të ri në debatet për qëndrueshmëri, trashëgimi dhe përfshirje sociale. Qëllimi i këtij raporti është të paraqesë gjetjet kryesore të studimit të realizuar në kuadër të projektit TRUST, duke ofruar një analizë të thelluar mbi ndikimin e ndryshimeve klimatike në praktikën e transhumancës në Shqipëri, dhe një kuadër rekomandimesh për ndërhyrje të përshtatura, të udhëhequra nga komuniteti dhe të mbështetura nga politika publike.

3. Konteksti i Transhumancës në Shqipëri

Transhumanca në Shqipëri është e rrënjësuar thellë në strukturën ekonomike dhe kulturore të shumë komuniteteve rurale, veçanërisht në zonat malore si Alpet Shqiptare, Lura, Has, Tropoja, Gramshi, Skrapari dhe Tomorri. Kjo praktikë përbën një sistem të veçantë të menaxhimit të bagëtive që lidhet ngushtë me lëvizjen sezonale ndërmjet bjeshkëve verore dhe zonave të ulëta dimërore. Në këtë sistem, barinjët organizojnë çdo vit udhëtime të rregullta, duke ndjekur rrugë tradicionale të quajtura “rrugë stani”, që shpesh ndodhen në kushte të vështira natyrore, pa mbështetje infrastrukturore, por që bartin një trashëgimi të jashtëzakonshme të dijes tradicionale.

Historikisht, transhumanca ka qenë një praktikë që siguron jo vetëm mbijetesën e familjeve baritore, por edhe ruajtjen e peizazhit natyror, përhapjen e plehut natyror në zona të ndryshme kullotore, si dhe ndihmesë në kontrollin natyror të bimësisë dhe mbrojtjen nga zjarret. Në zonat e thella të veriut,

raportet tregojnë se kjo praktikë ka luajtur një rol kyç në ruajtjen e strukturës ekonomike lokale, për shkak të mungesës së alternativave të tjera të qëndrueshme të jetesës (Gjeta, 2021). Megjithatë, gjatë tre dekadave të fundit, transhumanca shqiptare ka hyrë në një fazë të thellë rënieje. Një kombinim faktorësh e ka vendosur praktikën në pozitë të rrezikuar: shpopullimi i vazhdueshëm i zonave rurale dhe emigrimi masiv, plakja e popullsisë baritore, mungesa e trashegimtarëve të dijes, keqmenaxhimi i territorit dhe fragmentimi i pronësisë mbi kullotat. Një nga sfidat më të mëdha është mungesa e mbështetjes institucionale: mungojnë politika të qarta për mbrojtjen dhe zhvillimin e transhumancës, ndërsa shërbimet bazë në zonat e banuara vetëm sezonalisht janë pothuajse inekzistente (Adaptation Milou Albania, 2022; ASA Report, 2022).

Shqetësues mbetet edhe fakti që infrastruktura që lidhet me këtë praktikë është lënë në mëshirë të kohës. Rrugët e qasjes janë shpesh të pakalueshme, uji mungon në shumë zona të staneve dhe energjia elektrike është e padisponueshme. Vetë vendbanimet verore janë degraduar ose janë braktisur. Për më tepër, tregjet për produktet e transhumancës janë të paformalizuara dhe nuk ekziston asnjë mekanizëm që i ndihmon barinjtë të certifikojnë apo tregtojnë produkte si djathi i verës, mish i ruajtur në mënyrë tradicionale apo leshi.

Për më tepër, ndikimi i ndryshimeve klimatike – si pakësimi i reshjeve, thatësiat e zgjatura, zjarret e shpeshta, shkrirja e hershme e borës dhe reduktimi i burimeve ujore – po krijon kushte edhe më të vështira për organizimin dhe vijimësinë e kësaj praktike. Barinjtë raportojnë se kullotat që dikur përdorshin në qershor, tashmë nuk janë më produktive që në maj. Ujësjellësit natyrorë janë tharë ose ndotur, ndërsa ndryshimet në ciklet sezonale po shkaktojnë rritje të sëmundshmërisë tek kafshët (Risk Perception of Transhumance, 2022). Në këtë realitet kompleks, transhumanca shqiptare ka kaluar nga një praktikë jetike dhe e gjallë, në një fenomen të rrezikuar që mbijeton në forma të fragmentuara dhe kryesisht përmes përpjekjes individuale të barinjve. Pa një ndërhyrje të strukturuar institucionale dhe një vlerësim të saktë të sfidave të sotme, kjo praktikë ka gjasa të zhduket brenda një brezi.

3.1 Korniza Ligjore dhe Strategjike për Transhumancën në Shqipëri

Transhumanca, si një praktikë që përfshin dimensione sociale, kulturore, mjedisore dhe veterinare, ndërthurët me disa akte ligjore dhe dokumente strategjike që rregullojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi zhvillimin e saj në Shqipëri. Megjithëse nuk ekziston ende një ligj specifik për transhumancën, disa mekanizma të fragmentuar institucionalë dhe ligjorë adresojnë aspekte të veçanta të kësaj praktike tradicionale.

Në planin normativ, Ligji Nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar”, i ndryshuar, përbën bazën ligjore për garantimin e shëndetit të kafshëve në lëvizje dhe përcakton kompetencat e institucioneve përkatëse, si Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB) dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV). Ky kuadër rregullon proceset e kontrollit veterinar dhe lëshimin e certifikatave për lëvizjen e tufave gjatë sezonit të transhumancës. Po ashtu, Urdhri Nr. 26, datë 10.01.2025 dhe Urdhri Nr. 233, datë 07.03.2025, përfshijnë programet e kontrollit për sëmundjet e plasjes dhe brucelozës, të cilat kanë rëndësi të veçantë për blegtorinë ekstensive që praktikon shtegtimin sezonal.

Në aspektin e administrimit të territorit, procesi i decentralizimit të vitit 2008 i transferoi njësive të qeverisjes vendore përgjegjësinë për menaxhimin e një përqindjeje të konsiderueshme të kullotave

publike. Kjo e vendos qeverisjen lokale në një pozicion kyç për sa i përket aksesit të barinjve në kullota dhe mirëmenaxhimit të këtyre burimeve natyrore. Megjithatë, dokumentet e analizës së territorit dhe raportet e mëparshme evidentojnë mungesën e kapaciteteve administrative dhe orientimeve të qarta për menaxhimin afatgjatë të këtyre hapësirave në funksion të ruajtjes së transhumancës

.Në planin kulturor, njohja e transhumancës si pjesë e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të Njerëzimit nga UNESCO në dhjetor të vitit 2023 përbën një akt të rëndësishëm politik dhe simbolik. Ky status e vendos transhumancën në vëmendjen e institucioneve publike si një pasuri që duhet ruajtur dhe përçar. Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK), është institucioni përgjegjës për mbrojtjen e elementeve të kësaj trashëgimie dhe për integrimin e saj në politikat kombëtare të zhvillimit kulturor. Një aktor i rëndësishëm në këtë proces ka qenë Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF), i cili ka ofruar mbështetje për përgatitjen e dosjes së aplikimit në UNESCO dhe përfshirjen e ekspertëve të huaj dhe vendorë në dokumentimin e praktikës.

Megjithatë, mungesa e një ligji të dedikuar për transhumancën dhe fragmentimi ndërinstitutional mbeten sfida kryesore për operacionalizimin e këtyre përpjekjeve. Nevoja për një qasje të integruar mbetet kritike në kushtet e presioneve të shumta që përballet kjo praktikë, përfshirë ndryshimet klimatike, braktisjen rurale dhe mungesën e mbështetjes afatgjatë financiare dhe institucionale.

4. Metodologjia

Studimi është bazuar në një qasje të integruar kërkimore, që kombinon analizën e të dhënave të mbledhura në terren, kërkesat zyrtare për informacion pranë institucioneve publike dhe analizën e të dhënave klimatike të disponueshme. Objektivi metodologjik ka qenë të sigurohet një pasqyrë sa më e plotë mbi ndikimin e ndryshimeve klimatike në praktikën tradicionale të transhumancës në Shqipëri.

Për realizimin e këtij studimi janë ndjekur hapat e mëposhtëm:

4.1 Grumbullimi i përgjithshëm informacionit

Metoda: Vëzhgime në terren, hulumtim online

Periudha kohore: Korrik-Shtator 2024

Në fazën e parë, u realizua grumbullimi i informacionit dytësor përmes analizës së dokumenteve strategjike dhe ligjore në fuqi, literaturës shkencore, si dhe raporteve të projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare që lidhen me transhumancën, ndryshimet klimatike dhe blegtorinë ekstensive në Shqipëri. Gjithashtu, në kuadër të projektit, u drejtuan kërkesa zyrtare për informacion institucioneve përkatëse si Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) dhe Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), për të mbledhur të dhëna të detajuara mbi:

- Strategjitë aktuale dhe planet për transhumancën;
- Shëndetin veterinar të bagëtive dhe monitorimin e sëmundjeve;
- Politikën e administrimit të kullotave dhe kullotave publike

Për më tepër, u analizuan të dhëna klimatike të marra nga Climate Portal dhe bulletinet mujore të Institutit të Gjeoshkencave, për të studiuar ndryshimet e temperaturës mes viteve 1961–2021 në Shqipëri.

4.2 Grumbullimi i të Dhënave nga Veterinerët

Metoda: Anketë në të gjithë Shqipërinë

Periudha Kohore: Shtator-Tetor 2024

Nëpërmjet një pyetësoi të strukturuar të dizenuar për këtë qëllim, u mbledhën të dhëna nga **87 veterinerë** të përfshirë në zonat kryesore të transhumancës: Berat, Korçë, Dibër, Shkodër dhe Kukës. Pyetësoi kishte për qëllim të evidentonte perceptimet mbi ndryshimet klimatike, përhapjen e sëmundjeve në bagëti dhe sfidat e aksesit në shërbime veterinarë gjatë praktikës së shtegimit.

4.3 Grumbullimi i të Dhënave nga Barinjtë në Terren

Metoda: Anketë në të gjithë Shqipërinë

Periudha Kohore: Dhjetor 2024 - Mars 2025

Përmes intervistave gjysmë të strukturuar të kryera në Berat, Korçë, Dibër, Shkodër dhe Kukës, u grumbulluan të dhëna të detajuara mbi përvojat, perceptimet dhe praktikat adaptuese të **20 barinjve** në lidhje me: Ndryshimet klimatike dhe ndikimin mbi lëvizjet tradicionale; Qasjen në kullota dhe burime natyrore; Ndryshimet në sezonet e shtegimit dhe produktivitetin blegtoral etj.

4.4 Përpunimi i të dhënave

Metoda: EXCEL, R Studio

Periudha Kohore: Mars-Prill 2025

Përpunimi i të dhënave klimatike përfshiu analizimin e anomalive të temperaturës, duke përdorur të dhëna nga Climate Portal dhe përpunuar në programe të tilla si R dhe RStudio. Në mënyrë të veçantë, për trajtimin e të dhënave të temperaturës u ndoq metodologjia e përcaktuar nga Cheng M. et al. (2022), duke vlerësuar tendencat dekadale dhe anomalinë mesatare prej $+0.85^{\circ}\text{C}$ gjatë periudhës së fundit. Në përpunimin cilësor të intervistave me barinjtë, u aplikua analiza tematike për të identifikuar temat dominante që lidhen me pasojat e ndryshimeve klimatike mbi praktikën e transhumancës dhe jetesën tradicionale. Të gjitha të dhënat u trajtuan në përputhje me parimet e etikës së kërkimit, duke respektuar konfidencialitetin dhe përdorimin ekskluziv të informacionit për qëllime shkencore dhe analitike.

5. Hartëzimi i Aktorëve në Ruajtjen dhe Zhvillimin e Transhumancës në Shqipëri

Transhumanca, si një praktikë e ndërlidhur ngushtë me trashëgiminë kulturore, zhvillimin rural dhe menaxhimin e territorit, përfshin një rrjet kompleks aktorësh institucionalë, organizativë dhe komunitarë. Më poshtë paraqitet një pasqyrë e aktorëve kyç që kanë kontribuar ose kanë potencial për të luajtur një rol në ruajtjen dhe zhvillimin e transhumancës në Shqipëri.

5.1 Komuniteti lokal dhe praktikuesit

Barinjtë (Praktikuesit tradicionalë)

Aktorët kyç që mbajnë gjallë praktikën e transhumancës. Roli i tyre është qendror në transmetimin e dijes, ruajtjen e rregullave tradicionale të lëvizjes dhe menaxhimit të tufave. Ata janë njëkohësisht më të ekspozuarit ndaj sfidave mjedisore, institucionale dhe sociale.

5.2 Institucione publike

5.2.1 Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR)

Ka një rol të drejtpërdrejtë në hartimin e politikave për bujqësinë ekstensive dhe në menaxhimin e kullotave. Në bashkëpunim me projekte të huaja, ka mbështetur nisma pilot si “IVEA – Rrugët e gjelbra për blegtorinë shqiptare”. Gjithashtu është në proces hartimi të një Plan Strategjik Veprimi “Jeta baritore shtegtuese perspektivat e zhvillimit në Shqipëri”(2024). MBZHR ka synuar të rrisë ndërgjegjësimin institucional për rëndësinë e kësaj praktike. Gjithashtu, ministria ka bashkëpunuar me partnerë ndërkombëtarë në hartimin e politikave për ruajtjen e blegtorisë ekstensive si një formë zhvillimi të qëndrueshëm rural.

Në varësi të saj, **Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB)** ka një rol teknik në menaxhimin e shëndetit të kafshëve gjatë sezonit të lëvizjes, duke lëshuar certifikata veterinare për transhumancën dhe duke mbikëqyrur fushatat e vaksinimit, si ato kundër brucelozës dhe plasjes. Gjithashtu, **Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV)** siguron analizat laboratorike të sëmundjeve që prekin bagëtitë gjatë migrameve sezonale, duke ndihmuar në diagnostikim të saktë dhe kontroll të rreziqeve epidemiologjike.

5.2.2 Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI)

MEKI ka një rol themelor në mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, përfshirë transhumancën, dhe përfaqëson Shqipërinë pranë UNESCO-s në këtë fushë. Ministria ka mbështetur nisma për dokumentimin dhe promovimin e kësaj trashëgimie, si projekti i realizuar nga Shoqata ADAD Malore në veriun e vendit, dhe ka qenë promotore e përgatitjes së dosjes për njohjen e transhumancës si trashëgimi botërore.

Në varësinë e MEKI-t vepron **Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK)**, formuar nga bashkimi i Institutit të Monumenteve të Kulturës “Gani Strazimiri” dhe Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik. IKTK ka mandat për studimin, dokumentimin dhe mbrojtjen e elementeve të trashëgimisë materiale. Nga informacionet jo-zyrtare, ky institucion nuk ka kompetenca përsa i përket trashëgimisë jo-materiale deri më tani.

5.2.3 Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF)

ka luajtur një rol mbështetës thelbësor në procesin e njohjes së transhumancës shqiptare si Trashëgimi Kulturor Jomateriale e Njerëzimit nga UNESCO. Në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Kulturës (tani MEKI), AADF ka ofruar mbështetje financiare dhe asistencë teknike për përgatitjen e dosjes së aplikimit për UNESCO, duke angazhuar ekspertizë vendase dhe ndërkombëtare në këtë proces. Angazhimi i AADF në këtë drejtim nuk ka qenë vetëm teknik, por pjesë e një vizioni më të gjerë për integrimin e trashëgimisë kulturore shqiptare në rrjetet globale të vlerësimit dhe ruajtjes. Përmes kësaj nisme, AADF ka ndihmuar jo vetëm në sigurimin e statusit ndërkombëtar të transhumancës, por edhe në promovimin e saj si një vlerë që meriton mbrojtje, dokumentim dhe mbështetje institucionale në nivel kombëtar.

5.2.4 Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM)

MTM ka qenë pjesë e proceseve konsultuese për hartimin e Planit të Veprimit për “Jeta baritore shtegtuese perspektivat e zhvillimit në Shqipëri”, duke sjellë në tryezë perspektivën e zhvillimit të turizmit rural dhe mbrojtjes së peizazhit natyror si komponentë të ndërthurur me transhumancën. Ndonëse nuk ka rol të drejtpërdrejtë në mbikëqyrjen e praktikës, përfshirja e saj është e rëndësishme për zhvillimin e qasjeve integruuese në zonat e mbrojtura dhe ato alpine.

5.2.5 Njësitë e Qeverisjes Vendore

Autoritetet vendore kanë një funksion praktik në administrimin e kullotave publike, si dhe në dhënien me kontratë të drejtës së përdorimit sezonal. Në shumë zona, barinjtë varen nga bashkëpunimi me pushtetin vendor për akses në territor, furnizim me ujë apo zgjidhjen e konflikteve mbi përdorimin e tokës. Megjithatë, në mungesë të një kornize të qartë kombëtare për transhumancën, veprimtaria e njërive vendore mbetet e fragmentuar dhe jo gjithmonë në koherencë me parimet e menaxhimit të qëndrueshëm.

5.2.6 Organizata të Shoqërisë Civile dhe Aktorë të Terrenit

ADAD Malore (Shoqata për Zhvillimin e Bujqësisë në Rrethet Malore). Ka realizuar projekte dokumentuese mbi transhumancën në zonat e veriut, me mbështetje pjesërisht nga MEKI. Ka ekspertizë të drejtpërdrejtë në lidhje me komunitetet baritore. GO2 Albania dhe ANRD (Albanian Network for Rural Development). Organizata të njohura për angazhimin në zonat malore, me fokus në zhvillim të qëndrueshëm rural dhe menaxhim të territorit. Edhe pse nuk kanë projekte ekskluzive mbi transhumancën, kanë kontribut në zonat ku kjo praktikë është e gjallë dhe mund të luajnë rol në bashkëpunim, mobilizim dhe advokim. Royal Albania Foundation, Ka zhvilluar një projekt për transhumancën, edhe pse nuk ka informacion publik nëse është implementuar apo jo. Mund të konsiderohet si aktor potencial për bashkëpunim të ardhshëm. Reinforce Sustainability (RESU) Organizata që ka ndërmarrë një qasje të kombinuar kulturore dhe klimatike për transhumancën, përmes projektit TRUST. Ka përvojë të mëparshme në dokumentimin e trashëgimisë baritore dhe aktualisht po zhvillon një analizë gjithëpërfshirëse mbi ndikimin e ndryshimeve klimatike dhe perceptimet lokale.

5.2.7 Akademia dhe kërkimi shkencor


Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

Ka organizuar konferenca shkencore të fokusuara në transhumancën shqiptare dhe ndikimin e saj në trashëgimi, zhvillim rural dhe përfshirje kulturore. Akademikët e këtij universiteti kanë paraqitur punime në forume ndërkombëtare, përfshirë konferencën ndërkombëtare mbi transhumancën të organizuar nga Universiteti i Molise-s (Itali) në 2021.

Universitete të tjera si Universiteti i Tiranës apo Universiteti Bujqësor i Tiranës, Përmenden sporadikisht në kontekste rurale, por mungon një përfshirje e drejtpërdrejtë sistematike në kërkime të lidhura me transhumancën dhe ndryshimet klimatike. Kjo përbën një hapësirë potenciale për bashkëpunime të mëtejshme kërkimore.

Harta e Aktorëve të Transhumancës në Shqipëri

Rolet dhe marrëdhëniet institucionale, organizative dhe komunitare



6. Gjetjet kryesore dhe diskutimet

6.1 Rezultatet nga të dhënat institucionale dhe studimi bibliografik

Studimi përfshiu një analizë të thelluar të të dhënave të siguruara nga institucionet publike përgjegjëse për menaxhimin e transhumancës, blegtorisë dhe trashëgimisë kulturore. Këto të dhëna janë të domosdoshme për të ndërtuar një pasqyrë të qëndrueshme mbi përmasat, aktorët dhe sfidat e transhumancës në Shqipëri.


6.1.1 Përmasa e Transhumancës në Shqipëri

Sipas Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), rreth 400 ferma në Shqipëri ushtrojnë ende praktikën e transhumancës drejt kullotave verore dhe/ose dimërore. Këto përbëjnë afërsisht 7% të numrit total të fermave me blegtori të imët që mbarështojnë më shumë se 100 krerë bagëti. Tufat përkatëse përbëjnë rreth 97,000 krerë dele dhe dhi, ose 6% të numrit të përgjithshëm të tufave me të paktën 100 krerë. Ky numër, megjithëse modest në përqindje, përfaqëson një pjesë thelbësore të komuniteteve baritore që ruajnë praktikën tradicionale të lëvizjes sezonale dhe përdorin dijet lokale për menaxhimin e territorit.

Aktualisht, në Shqipëri janë të punësuar 530 veterinerë zyrtarë në katër Drejtoritë Rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve. Në kuadër të këtij studimi, janë intervistuar 87 veterinerë, që përfaqësojnë afërsisht 16.4% të trupës zyrtare veterinare publike në vend. Kjo përqindje siguron një bazë të qëndrueshme për nxjerrjen e tendencave në perceptimin profesional mbi ndikimin e ndryshimeve klimatike në blegtorinë ekstensive dhe shëndetin e kafshëve.


Përmasat e Transhumancës në Shqipëri

Ferma me Transhumancë



Pjesëmarrja e Veterinerëve në Studim

Veterinerë të intervistuar



Të dhënat nga MBZHR dhe INSTAT tregojnë se në vitin 2023:

Janë regjistruar 1,006,328 dele dhe 511,950 dhi, çka përbën një total prej 1.52 milionë krerë bagëti të imta. Në krahasim me vitin 2022, ka një rënie me rreth 12% të numrit të krerëve, duke sinjalizuar një tendencë në tkurrje të këtij sektori blegtoral.


6.2.2 Politikat dhe projektet mbështetëse për transhumancën

MBZHR ka ndërmarrë nismën për hartimin e një Plani Strategjik Veprimi të titulluar “Jeta baritore shtegtuese”, i cili synon të ofrojë një qasje të integruar për ruajtjen dhe transformimin e praktikës. Krahas kësaj, është realizuar edhe projekti “IVEA – Rrugët e Gjelbra për Blegtorinë Shqiptare”, me objektiva konkrete si:

- Pajisja e staneve me ftohës qumështi me energji diellore (modeli i zbatuar në Fushë-Çajup, Gjirokastër);
- Trajnimi i barinjve për prodhimin e djathit të presuar tip “Tomme” me identitet të kontrolluar;
- Mbështetje për instalimin e paneleve diellore në stane.
- Këto ndërhyrje janë shembuj praktikë të inovacionit në funksion të përmirësimit të jetesës baritore dhe cilësisë së produkteve me origjinë blegtorale.

6.2.3 Ndryshimet klimatike dhe ndikimi i tyre në Shqipëri

Analiza e të dhënave klimatike për periudhën 1961–2021, bazuar në Climate Portal të IGJEUM dhe të dhëna të përpunuara sipas metodologjisë së Cheng M. et al. (2022), tregon një tendencë të qartë rritjeje të temperaturës mesatare vjetore në Shqipëri.




Gjatë këtyre gjashtë dekadave, temperatura mesatare ka shënuar një rritje prej +0.85°C, duke e pozicionuar Shqipërinë në linjë me tendencat rajonale të ngrohjes që raportohen në Europën Juglindore


Kjo rritje mund të sjellë pasoja të dukshme për ciklin sezonal dhe disponueshmërinë e burimeve natyrore që lidhen drejtpërdrejt me praktikën e transhumancës. Rritja e temperaturave ka ndikuar në: Zgjatjen e periudhave të thatësirës në zonat fushore dhe kodrinore, duke detyruar barinjtë të përshpejtojnë apo shtyjnë periudhat e shtegtitimit.

Sipas të dhënave të Climate Portal, verat shqiptare kanë shfaqur një rritje të ndjeshme të temperaturës mesatare, me disa zona që regjistrojnë mbi 2°C ngrohje krahasuar me vitet '60. Ndërkohë, stinët e ndërmjetme (pranvera dhe vjeshta) janë bërë më të shkurtër dhe të paparashikueshme, duke vështirësuar kohëzgjatjen dhe itineraret e transhumancës.

Max-Temperature Monthly Trends; Albania



Min-Temperature Monthly Trends; Albania



Të dhënat klimatike tregojnë një rritje të vazhdueshme të temperaturave maksimale dhe minimale mujore në Shqipëri, me theks të veçantë gjatë dekadës 2011–2020. Ndërsa verat janë bërë më të nxehta dhe e bëjnë të pamundur qëndrimin e gjatë në fusha, rritja e temperaturave minimale në dimër ka një ndikim më pak të dukshëm, por shumë domethënës: mungesa e reshjeve të borës dhe shkrirja e parakohshme e saj ka ulur ndjeshëm rezervat natyrore të ujit në mal, duke bërë që kullotat verore të thahen më shpejt dhe stinët e transhumancës të shkurtohen. Kjo ndikon drejtpërdrejt në qëndrueshmërinë e praktikës, pasi bagëtitë nuk kanë më akses të vazhdueshëm në ujë gjatë muajve të verës dhe barinjtë detyrohen të ndërpresin më herët ciklin tradicional të qëndrimit në lartësi.

Në këtë kontekst, ndryshimet klimatike përbëjnë një kërcënim të drejtpërdrejtë dhe afatgjatë për vijueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e praktikës së transhumancës në Shqipëri. Ndikimi i tyre po vë në provë jo vetëm adaptimin e kafshëve dhe barinjve, por edhe modelet tradicionale të përdorimit të territorit, të trashëguara prej brezash.


6.2 Gjetjet nga intervistat me barinjtë

Të gjithë barinjtë e intervistuar deklaruan se nuk e kishin dëgjuar më parë termin “Transhumancë”. Megjithatë, kur u përdor termi “shtegtimi i bagëtive”, të gjithë e pranuan se e njohin plotësisht këtë si një praktikë që e ushtrojnë vetë çdo vit. Kjo tregon se ekziston një ndarje mes terminologjisë teknike dhe praktikës tradicionale, duke nënvizuar nevojën për komunikim më të përshtatur në politikat dhe ndërhyrjet publike.

6.2.1 Përbërja e tufës dhe karakteristikat e lëvizjes

98% e të intervistuarve deklaruan se tufat e tyre përbëhen nga dele, me numër krerësh që varion nga 100 deri në 500. Të gjithë të anketuarit realizojnë të paktën një herë në vit shtegtim, ndërsa disa raportuan dy herë në vit, në varësi të kushteve klimatike dhe kullotave. E gjithë praktika që përshkruajnë barinjtë është transhumancë vertikale, pra lëvizje sezonale nga ultësirat drejt zonave alpine dhe anasjelltas.

Në lidhje me stinët dhe frekuencën e shtegimit, shumica e barinjve përmendën pranverën dhe dimrin si periudha kryesore. Ata vlerësuan ndryshimin e temperaturave si faktor kyç për nisjen e shtegimit, me një mesatare prej 4.8 pikësh nga një shkallë vlerësimi 1–5. Po ashtu, disponueshmëria e foragjereve dhe shmangia e kullotjes së tepërt ishin arsye të rëndësishme, me vlerësime përkatësisht 4.5 dhe 3.9.



Shumë barinj raportuan se ndryshimet klimatike kanë sjellë një zhvendosje të qartë në kohën e nisjes së shtegtimin. Ndryshe nga vitet e mëparshme kur transhumanca fillonte në fillim të tetorit, në vitin 2024 ajo nisi vetëm në fund të nëntorit. Ndërsa në pranverë, nisja ka kaluar nga prilli në maj apo qershor. Këto ndryshime lidhen drejtpërdrejt me vonesat në gjelbërimin e kullotave dhe mungesën e reshjeve.

Faktorët biofizikë më të përmendur që ndikojnë negativisht në shtegtimin tradicional janë mungesa e burimeve të ujit përgjatë rrugës, shkrirja e vonuar e borës në zonat malore, prania e specieve të rrezikshme, dhe zjarrvënja e qëllimshme në pyje. Sipas tyre, delet janë lloji më i ndjeshëm ndaj këtyre ndryshimeve.

Për sa i përket sfidave për mbijetesën e praktikës, të intervistuarit theksuan tre çështje kryesore: mungesa e një statusi ligjor për barinjtë, rënia e popullsisë në zonat rurale dhe mungesa e informacionit për të përfituar nga subvencionet qeveritare ose ndërkombëtare.

Së fundmi, si masa që mund të ndihmonin në zhvillimin e transhumancës, ata përmendën nevojën për sigurimin e një toke të përshtatshme për shtegtim, ruajtjen e ushqimit dhe aksesin e qëndrueshëm në burime uji.

6.3 Gjetjet nga të dhënat e veterinerëve


6.3.1 Profili demografik

Në kuadër të këtij studimi, u anketuan gjithsej 87 veterinerë të angazhuar në rajonet ku praktikohet transhumanca, përfshirë qarqet Berat, Korçë, Dibër, Kukës dhe Shkodër. Pjesëmarrja përfaqëson rreth 16.4% të trupës së veterinerëve zyrtarë në Shqipëri, duke ofruar një bazë solide për nxjerrjen e tendencave në raport me shëndetin e kafshëve dhe ndikimin e ndryshimeve klimatike.

Një ndër aspektet kryesore të profilit demografik është shpërndarja gjinore e pjesëmarrësve. Nga të dhënat e përpunuara, rezulton se 76 nga të anketuarit janë burra (87.4%) dhe 11 janë gra (12.6%). Kjo dëshmon për një dominim mashkullor në sektorin veterinar, veçanërisht në shërbimet e terrenit dhe ato që kanë lidhje direkte me komunitetet baritore. Megjithatë, prania e një numri në rritje të veterinerëve femra, edhe në zonat me karakter rural, është një tregues pozitiv i ndryshimeve të ngadalta në përfaqësimin gjinor dhe përfshirjen profesionale. Nga të dhënat rezulton se 61% e veterinerëve të anketuar kanë punuar drejtpërdrejt me barinjtë që praktikojnë transhumancën, ndërsa 39% kanë pasur kontaktë jo të drejtpërdrejt.

Analiza e viteve të eksperiencës së veterinerëve të anketuar nxjerr në pah një shpërndarje të balancuar ndërmjet brezave të ndryshëm profesionalë. Nga të dhënat rezulton se 44% e të anketuarve kanë më pak se 10 vite përvojë, duke përfaqësuar një brez të ri që po zëvendëson gradualisht profesionistët me përvojë të gjatë. Rreth 29% e pjesëmarrësve kanë një eksperiencë që varion nga 10 deri në 20 vite, çka sugjeron një kohortë të qëndrueshme veterinerësh, që janë profesionalisht të konsoliduar dhe mbajnë një pozicion kyç në ndërlidhjen midis praktikës veterinare dhe administratës lokale. Ndërkohë, 27% e të anketuarve kanë më shumë se 20 vite përvojë, duke reflektuar një brez me njohuri të thelluara mbi transformimet që ka pësuar sektori i blegtorisë ekstensive dhe transhumanca në Shqipëri.


Kategoritë e Eksperiencës së Veterinerëve të Anketuar



6.3.2 Analiza tematike e përvojës dhe vlerësimeve të veterinerëve


6.3.2.1 Ndikimi i ndryshimeve klimatike në prodhimet blegtorale

Si kanë ndikuar ndryshimet klimatike në prodhimin e qumështit, mishit dhe cilësinë e tyre? (Përdorni shkallën 1 - Aspak ndikim deri në 5 - Ndikim shumë i madh.)



Të dhënat e mbledhura tregojnë se pjesa dërrmuese e veterinerëve e perceptojnë ndikimin e

ndryshimeve klimatike si të konsiderueshëm në produktivitetin blegtoral. Konkretisht, 47 veterinerë (rreth 54%) vlerësuan se sasia e qumështit të prodhuar është prekur në nivel mesatar ose të lartë (shkalla 3 dhe 4), ndërsa vetëm një numër shumë i vogël e konsideruan ndikimin si të papërfillshëm. Për cilësinë e qumështit, 43 veterinerë dhanë një vlerësim nga shkalla 3 deri në 4, duke sinjalizuar ndjeshmëri ndaj përmbajtjes ushqyese, e cila ndikohet nga cilësia e ushqimit dhe mungesa e ujit gjatë stinëve të thata. Edhe sasia e mishit të prodhuar rezultoi me vlerësim të lartë – mbi 45 përgjigje janë në shkallët 3 dhe 4, ndërsa për cilësinë e mishit, rreth 40 veterinerë dhanë përgjigje që tregojnë ndikim të moderuar deri të lartë. Pothuajse në të gjitha rastet, shkalla 1 (aspak ndikim) është përdorur rrallë ose fare, gjë që nënvizon konsensusin mbi faktin që ndryshimet klimatike janë tashmë një faktor i perceptuar qartë në uljen e rendimentit blegtoral në Shqipëri.




Vërehet një tendencë e qartë: sa më e gjatë të jetë përvoja profesionale, aq më i lartë është perceptimi për ndikimin negativ të ndryshimeve klimatike në prodhimin dhe cilësinë e qumështit dhe mishit.

Veterinerët me mbi 20 vite eksperiencë japin vlerësime mesatare më të larta në të katër treguesit, duke reflektuar njohuri të thelluara dhe përvojë të drejtpërdrejtë me transformimet klimatike dhe efektet e tyre në terren. Nga ana tjetër, grupi me më pak se 10 vite përvojë shfaq vlerësime më të moderuara, gjë që mund të lidhet me një mungesë të perspektivës krahasuese ndër vite.

6.3.2.2 Ndikimi i klimës në burimet ushqimore dhe ujin për bagëti


Veterinerët e anketuar raportojnë se ndryshimet klimatike kanë ndikuar ndjeshëm në disponueshmërinë dhe cilësinë e burimeve bazë për bagëtinë, si ushqimi dhe uji. Pothuajse 37% e tyre theksojnë një rritje të varësisë nga ushqimet e blera (koncentrate), për shkak të reduktimit të foragjereve natyrore. Ndërkohë, afro 29% raportojnë një zvogëlim të sipërfaqeve të kullotave, duke e bërë gjithnjë e më të vështirë mbështetjen në burimet lokale.

Ndikimi i Klimës në Ushqimin për Bagëti (sipas veterinerëve)



Nga të dhënat rezulton se 72.4% e veterinerëve vlerësojnë se ndryshimet klimatike kanë ndikuar në ujin e disponueshëm për bagëtitë, ndërsa vetëm 27.6% nuk kanë konstatuar ndonjë ndikim të drejtpërdrejtë.

Lloji i bagëtive që preken më shumë nga ndryshimet klimatike (sipas veterinerëve)




Të dhënat tregojnë se nuk ka një konsensus absolut mes veterinerëve për llojin e bagëtive që preken më shumë nga ndryshimet klimatike, por tre kategori mbizotërojnë. Dhentë (33.3%), lopët (32.2%) dhe dhitë (31%) përmenden pothuajse në mënyrë të barabartë si më të ndikuarat, ndërsa pjesa tjetër e përgjigjeve përfshijnë raste të izoluar që theksojnë ndikimin tek të gjitha kafshët njësoj, ose te kategori të tjera më të vogla. Kjo tregon se ndikimi është i pranishëm në të gjitha llojet kryesore të

blegtorisë, duke reflektuar pasigurinë dhe ndikimet e ndryshme të klimës në varësi të zonës dhe praktikës blegtorale.

6.3.3 Vlerësimi i praktikës së transhumancës nga veterinerët


Të dhënat e mbledhura nga veterinerët e anketuar tregojnë qartë një perceptim të përgjithshëm mbi rritjen e rasteve të sëmundjeve tek bagëtitë gjatë viteve të fundit. Rreth 70% e të anketuarve konfirmojnë se kanë vërejtur një rritje të ndjeshme të frekuencës së sëmundjeve, krahasuar me periudhat e mëparshme. Ky vlerësim vjen nga profesionistë që operojnë në zona të ndryshme të vendit, përfshirë rajonet me prani të fortë të blegtorisë ekstensive dhe praktikës së transhumancës.

A është rritur frekuenca e sëmundjeve tek bagëtitë?




Komunikimi ndërmjet veterinerëve dhe barinjve mbetet kryesisht tradicional dhe i bazuar në kontakt të drejtpërdrejtë. Më shumë se gjysma e veterinerëve (52.3%) deklarojnë se vizitojnë fizikisht stanet, ndërsa një pjesë e konsiderueshme përdor telefonin (35.2%) për të dhënë udhëzime dhe trajtim në distancë. Përdorimi i dy kanaleve njëkohësisht është më i rrallë, duke sugjeruar nevojën për forcim të sistemit të ndjekjes në terren, sidomos në kohë krizash klimatike kur shfaqja e sëmundjeve mund të kërkojë ndërhyrje të menjëhershme.

Mënyra e lëvizjes së tufës (sipas veterinerëve)



Sipas veterinerëve të pyetur, mënyra mbizotëruese e lëvizjes së tufës gjatë transhumancës mbetet ecja në këmbë, duke ruajtur lidhjen me rrugët tradicionale dhe ritmin natyror të kafshëve. Megjithatë, në më shumë se një të katërtën e rasteve përdoren mjete motorike për të transportuar bagëtitë, veçanërisht në zona me infrastrukturë të përshtatshme ose për distanca të gjata. Një pjesë e vogël aplikon një formë të përzier, duke kombinuar ecjen me transportin mekanik. Kjo tregon për një ndryshim të moderuar të praktikës tradicionale, ndikuar nga faktorë logjistikë, ekonomikë dhe klimatikë.


Periudha e nisjes së bagëtive drejt maleve (sipas veterinerëve)



Të dhënat e mbledhura nga veterinerët tregojnë se **periudha më e zakonshme për nisjen e bagëtive drejt kullotave alpine** është muaji **maj**, ndjekur nga **qershori**, që përkojnë me përmirësimin e kushteve

klimatike dhe gjelbërimin e kullotave malore. **Prilli** dhe **korriku** përmenden më rrallë si muaj nisjeje, ndërsa muajt e tjerë, si **janari**, **shkurti** apo **gushti**, përmenden shumë pak ose aspak. Kjo shpërndarje konfirmon se **transhumanca në Shqipëri ndjek ende një ritëm sezonal të ndikuar drejtpërdrejt nga temperaturat dhe disponueshmëria e ushqimit në lartësi.**


Periudha e kthimit të bagëtive nga mali në fushë (sipas veterinerëve)



Pas përfundimit të sezonit të verës, **kthimi i bagëtive nga kullotat malore në fushë ndodh zakonisht gjatë muajve tetor dhe shtator**, sipas vlerësimeve të veterinerëve. **Tetori** rezulton muaji më i zakonshëm i zbritjes, çka përputhet me uljen graduale të temperaturave dhe reduktimin e burimeve natyrore në lartësi. **Shtatori**, megjithëse më pak i përmendur, është gjithashtu një periudhë tranzitore që sinjalizon fillimin e lëvizjes së hershme për disa blegtori. **Rastet e kthimit në nëntor** janë të kufizuara dhe lidhen me ndonjë shtyrje të sezonit për shkak të motit më të ngrohtë se zakonisht.

6.3.4 Dinamika e Sëmundjeve në Kontekstin e Ndryshimeve Klimatike


Një ndër sfidat më të qarta që lidhet me ndikimin e ndryshimeve klimatike në blegtorinë ekstensive është shfaqja e më shpeshtë dhe më agresive e sëmundjeve tek bagëtitë. Të dhënat e mbledhura nga ky studim tregojnë se 70.1% e veterinerëve të anketuar raportojnë një rritje të dukshme të frekuencës së sëmundjeve gjatë viteve të fundit. Kjo tendencë përkon me konstatimet e shumta ndërkombëtare që lidhin stresin termik, mungesën e ujit dhe ndryshimet në foragjere me përkeqësimin e shëndetit të bagëtive.



Veterinerët janë aktorë kyç në mbrojtjen e shëndetit të kafshëve dhe në mbajtjen nën kontroll të përhapjes së patologjive që mund të rrezikojnë si produktivitetin e tufave, ashtu edhe sigurinë ushqimore. Përveç rritjes së rasteve të sëmundjeve, ata kanë raportuar edhe ndryshim në llojet më të shpeshta të sëmundjeve, me një zhvendosje drejt patologjive që ndikohen nga faktorët klimatikë, si parazitozat, infeksionet bakteriale, sëmundjet dermatologjike dhe problemet riprodhuese.

9. Cilat sëmundje kanë pasur një rritje të frekuencës së shfaqjes gjatë viteve të fundit? (Mund të zgjidhni më shumë se një opsion.)

87 responses




Sipas veterinerëve të anketuar, sëmundjet që kanë pasur një rritje të ndjeshme të frekuencës së shfaqjes gjatë viteve të fundit përfshijnë një gamë të gjerë patologjish që lidhen drejtpërdrejt me ndikimet klimatike. 34.5% e përgjigjeve i referohen mastitit – një infeksion i gjëndrave të qumështit që ndikohet nga higjiena, temperatura dhe stresi termik. Infeksionet bakteriale përbëjnë 19.5% të rasteve, ndërsa parazitozat si babesioza dhe theilerioza përbëjnë 16.1%, të lidhura ngushtësisht me ndryshimet në ciklet ekologjike të vektorëve.

Gjithashtu, sëmundjet dermatologjike, problemet gastrointestinale si diarretë, dhe pneumonia, janë përmendur shpesh nga veterinerët si pasoja të ndryshimeve të motit dhe cilësisë së ushqimit. Këto gjetje sugjerojnë se ndryshimet klimatike nuk ndikojnë vetëm në sasinë e prodhimit blegtoral, por edhe në profilin shëndetësor të tufave, duke kërkuar përshtatje të vazhdueshme të sistemit të monitorimit veterinar dhe përkujdesjes në terren.


6.3.4 Përshtatja e Praktikës së Transhumancës përballë Ndryshimeve Klimatike: Sfidat dhe Masat nga veterinerët.

Vërejtja mbi zvogëlimin e numrit të bagëtive në transhumancë



Një tregues domethënës për gjendjen aktuale të transhumancës në Shqipëri është vlerësimi përshtypjes së veterinerëve mbi dinamikën e numrit të bagëtive të përfshira në këtë praktikë. Sipas rezultateve të pyetësorit, 70.4% e veterinerëve deklarojnë se kanë vërejtur një rënie të ndjeshme të numrit të bagëtive që ndjekin transhumancën, çka konfirmon prirjen drejt reduktimit të kësaj praktike tradicionale.


Arsyet kryesore për rënien e transhumancës (sipas veterinerëve)



Për të kuptuar më thellësisht faktorët që po çojnë në rënien graduale të transhumancës në Shqipëri, studimi analizoi përgjigjet cilësore të veterinerëve mbi shkaqet kryesore të kësaj prirjeje. Nga analiza tematike, u identifikuan pesë kategori përfaqësuese që përmbledhnin shkaqet më të shpeshta. Faktorët më të përmendur lidhen me shpopullimin e zonave rurale dhe mungesën e fuqisë punëtore – një realitet që reflekton zhvendosjen demografike, plakjen e popullsisë blegtorale dhe mungesën e të rinjve të përfshirë në këtë praktikë. Kjo kategori përbënte mbi një të tretën e përgjigjeve të mbledhura. Pas saj renditet zvogëlimi i numrit të krerëve të bagëtive dhe fermerëve aktivë, i lidhur drejtpërdrejt me rënien e interesit ekonomik dhe sfidat e menaxhimit blegtoral në kushte të vështira.

Një tjetër kategori thelbësore është reduktimi i aksesit në kullota dhe burime natyrore, për shkak të thatësirave, degradimit të bimësisë dhe konfliktit me forma të tjera të përdorimit të tokës. Gjithashtu, mungesa e mbështetjes institucionale – përfshirë subvencionet dhe skemat e mbrojtjes sociale për barinjtë – është përmendur si faktor penalizues për mbijetesën e transhumancës. Së fundi, disa veterinerë kanë vënë në dukje ndryshimet në modelet e prodhimit dhe teknologjizimin e sektorit, që po e zëvendëson gradualisht praktikën tradicionale me modele më intensive dhe sedentare.


Sfidat kryesore për përshtatjen e transhumancës me ndryshimet klimatike



Sipas veterinerëve të pyetur, sfida më e përmendur është mungesa e burimeve thelbësore, siç janë kullotat, uji dhe ushqimi për bagëtitë (33 përmendje). Ky realitet reflekton ndikimin konkret që kanë kushtet klimatike mbi infrastrukturën natyrore të transhumancës.

Në vend të dytë renditet mungesa e informacionit mbi mënyrat e përshtatjes klimatike (28 përmendje), duke sinjalizuar një boshllëk të theksuar në trajnim dhe shkëmbim njohurish mes institucioneve dhe blegtorëve. Kjo mungesë i ekspozon fermerët ndaj rrezikut të marrjes së vendimeve të gabuara ose të vonuara në një mjedis gjithnjë e më të paqëndrueshëm klimatikisht.

Mbështetja e pamjaftueshme nga qeveria (21 përmendje) dhe mungesa e subvencioneve financiare (20 përmendje) përmenden gjithashtu si pengesa serioze. Këto tregojnë një mungesë të qasjes në mekanizma ndihmues institucionalë, të cilët mund të ndihmonin në përmirësimin e kapaciteteve adaptive të aktorëve në terren.



Masat që blegtorët po ndërmarrin për të përballuar pasojat e ndryshimeve klimatike tregojnë një përgjigje të përqendruar në tre drejtime kryesore të adaptimit praktik. Më të përmendurat janë ndryshimi i racave të bagëtive dhe rritja e vaksinimeve, secila me 30 përmendje. Ndryshimi i racave përfaqëson një strategji biologjike adaptuese që synon të zëvendësojë bagëtitë ekzistuese me varietete më rezistente ndaj kushteve të reja klimatike, si thatësira ose temperatura ekstreme. Paralelisht, rritja e vaksinimeve sugjeron një përpjekje për të parandaluar shpërthimet e sëmundjeve, të cilat janë intensifikuar nga ngrohja globale dhe mungesa e kushteve optimale të higjienës në terren. Në vendin e tretë renditet rritja e përdorimit të ushqimeve të blera (koncentrate), që tregon se mungesa e foragjereve natyrore dhe pakësimi i bimësisë në kullota po kompensohen me inpute të blera, çka ndikon drejtpërdrejt në koston e prodhimit. Po ashtu, një pjesë e vogël e të intervistuarve përmend investimet në sisteme të reja ujitjeje, duke sinjalizuar nevojën për teknologji mbështetëse që ndihmon menaxhimin e ujit në periudha të thatësirës.

7. Konkluzione

Nga të dhënat e mbledhura dhe analiza e thelluar cilësore dhe sasiore, rezulton se transhumanca në Shqipëri është një praktikë në rënie progresive, por që ende ruan një rol të rëndësishëm për zhvillimin rural, ruajtjen e biodiversitetit dhe trashëgimisë kulturore. Konstatimet nga barinjët dhe veterinerët evidentojnë një mori faktorësh që po ndikojnë negativisht në qëndrueshmërinë e kësaj praktike, duke filluar nga mungesa e burimeve natyrore, ndikimet e drejtpërdrejta të ndryshimeve klimatike, dhe

deri te shpopullimi i zonave malore dhe mungesa e fuqisë punëtore. Transhumanca, në këtë raport, nuk shihet vetëm si objekt studimi, por si një formë jetese e cila po përballet me transformime të thella. Ndryshimi i kalendarëve sezonalë të lëvizjes, reduktimi i numrit të bagëtive dhe i fermerëve aktivë, si dhe përhapja më e madhe e sëmundjeve, janë vetëm disa nga simptomat që dëshmojnë krizën e kësaj praktike.

Në mënyrë të veçantë, ky raport nënvizon se klima është bërë një faktor gjithnjë e më përcaktues në ritmet dhe karakteristikat e transhumancës. Thatësirat e zgjatura, mungesa e reshjeve në muajt kritike dhe vështirësitë në sigurimin e ujit janë realitete të përmendura gjerësisht nga aktorët e terrenit. Kjo përforcon nevojën për një qasje kombëtare të integruar, që e konsideron transhumancën si një mjet adaptimi ekologjik dhe ekonomik, përtej aspektit të trashëgimisë.

Konkluzioni i përgjithshëm është se nëse nuk merren masa konkrete dhe të koordinuara institucionale, kjo trashëgimi jomateriale e mbrojtur nga UNESCO rrezikon të zëvendësohet nga forma intensive dhe të centralizuara të blegtorisë, duke humbur jo vetëm vlera kulturore, por edhe funksione ekologjike të rëndësishme. Transhumanca mund të bëhet pjesë e një strategjie kombëtare të zhvillimit të qëndrueshëm, por për këtë kërkohet një ndërhyrje urgjente, ndërinstitutionale dhe e orientuar drejt komunitetit.



8. Referencat

1. Transhmanca, një pasuri jomateriale e Shqipërisë, UBT green, <https://ubgreen.al/transhmanca-nje-pasuri-jomateriale-e-shqiperise/>
2. Albanian Transhumance, <https://regjistrickj.al/en/shtegetimi-i-bagetive/>
3. Transhumance in Kelmend, Northern Albania, https://ëëë.berghahnbooks.com/downloads/OpenAccess/BindiGrazing/BindiGrazing_05.pdf
4. Kume K., Bicoku Y., Papa L. Sheep and goat production in hill and mountainous regions in Albania: Extension service and government subsidies. In: Dubeuf J.-P. (ed.). L'évolution des systèmes de production ovine et caprine: avenir des systèmes extensifs face aux changements de la société. Zaragoza: CIHEAM, 2004. p. 271-277 (Options Méditerranéennes : Série A. Séminaires Méditerranéens; n. 61)
5. **Gjeta, Z.** (2020). *Për një zhvillim të qëndrueshëm të blegtorisë në zonën e veriut të Shqipërisë*. Shoqata ADAD Malore.
6. **Gjeta, Z.** (2021). *Analizë e kostove të bariut në Shqipëri*. Shoqata ADAD Malore.
7. **ASA Report.** (2022). *Adaptive management of high natural value grasslands and transhumance systems in the Balkans*. ASA & GEF-UNDP.
8. **Milou, V.** (2022). *Adaptation and climate resilience of transhumant systems in the Western Balkans*. International Land Coalition & FAO.
9. **Instituti i Gjeoshkencave (IGJEUM)** (2023). *Buletinet mujore klimatike dhe trendet e temperaturës për Shqipërinë (1961–2021)*. <https://igjeum.gov.al>
10. **Transhumance in the EU.** (2021). *Report of the European Parliament - Committee on Agriculture and Rural Development*. <https://www.europarl.europa.eu>
11. **UNESCO.** (2019). *Transhumance, the seasonal droving of livestock along migratory routes in the Mediterranean and Alps*. <https://ich.unesco.org>
12. **Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR).** (2024). *Përgjigje zyrtare mbi politikat për transhumancën dhe situatën e bagëtive në Shqipëri*.
13. **Cheng, M. et al.** (2022). *Decadal Temperature Anomalies and Adaptation Strategies in Pastoral Systems*, *Journal of Climate Impact Research*, Vol. 28(4), pp. 215–230.
14. **AADF.** (2020). *Supporting the UNESCO inscription process for transhumance in Albania*. <https://aadf.org>
15. **Konferenca Ndërkombëtare për Transhumancën (Shkodër, 2021)** – Universiteti i Shkodrës & Universiteti i Molises.